



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 8. 04. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ramadan Avdiu, Ramë Buja, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri dhe Ardian Gjini.

Munguan: Ibrahim Gashi, Nexhat Daci dhe Dragisa Miric.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin të pranishëm: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i rekomandimeve të komisioneve për Projektligjin për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua njëzëri.

- 1. Shqyrtimi i rekomandimeve të komisioneve për Projektligjin për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës**

Sabri Hamiti –njoftoi anëtarët e Komisionit se komisionet kryesore: Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisionit për Integritet Evropian, Komisioni për Legjislacion, Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve kanë nxjerrë rekomandimet e tyre lidhur me Projektligjin për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, ku rekomandojnë që Projektligji të procedohet për miratim në Kuvend. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka propozuar një amendament, në amendamentin 41 të komisionit tonë që i referohet nenit 36 të Projektligjit si vijon:

Amendamenti 1

Amendamenti 41 që i referohet nenit 36 të Projektligjit, të plotësohet si në vijim:

Në grupin e II, pas shprehjes “Ministrat e Qeverisë sipas listës së dekretimit”, shtohet “Zëvendësministrat e Qeverisë”, dhe pas shprehjes “Kryetarët e Komisioneve Parlamentare” shtohet “Zëvendëskryetarët e Komisioneve Parlamentare”.

Në grupin e III, pas shprehjes “Kryetarët e komunave”, shtohet shprehja “Zëvendëskryetarët e Komunave”.

Në cilësi të komisionit funksional ne duhet të përcaktohemë se a e përkrahim apo jo këtë amendament.

Enis Kervan tha se edhe në mbledhjen e kaluar kam propozuar që Zëvendëskryetarët e komunave të rangohen si pjesë e protokollit por nuk është cekur në procesverbal, këtë propozim e kam bërë edhe në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe e mbështesë amendamentin në fjalë.

Lidhur me amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve diskutuan A. Gjini, L. Haziri, E. Kryeziu, dhe R. Avdiu të cilët nuk e përkrahën amendamentin, me arsyetim se përfaqësimi etnik ekziston në nivel ministror prandaj nuk do të duhej të ishte kriter për rangim në këtë Projektligj si dhe me arsyetimin tjetër se amendamenti i propozuar mund të shkaktoj konfuzion në grupet e rangimit .

Komisioni pas diskutimit, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Nuk përkrahet amendamenti i propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

3. Të ndryshme

3.1. Sabri Hamiti njoftoi anëtarët e Komisionit se është parashtruar kërkesa nga deputeti Arsim Rexhepi dhe është përsëritur nga GP i LDK-së për formimin e Grupit të miqësisë në mes të Bundestagut të Gjermanisë dhe Kuvendit të Kosovës. Propozoi që Komisioni të përkrahë iniciativën për formimin e këtij grupi të miqësisë si të domosdoshëm dhe t'i propozoj Kryesisë së Kuvendit formimin e tij.

Komisioni pas diskutimit nxori këtë

P ë r f u n d i m

T'i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës t'a miratojë nismën për formimin e Grupit të Miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Bundestagut të Gjermanisë.

Grupi i Miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Bundestagut të Gjermanisë, të përbëhet fillimisht nga përfaqësues prej secilit grup parlamentar dhe nga një sekretar i caktuar për këtë Grup të Miqësisë, me mundësi për plotësim varësisht nga interesat dhe aktivitetet që do të zhvillohen ndërmjet parlamenteve.

3.2 Sabri Hamiti lidhur me kërkesën për lejimin e vizitës së delegacionit të Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë në Kosovë, tha se Kryesia e Kuvendit ka miratuar kërkesën për lejimin e vizitës. Gjatë kësaj vizite do të mbahet një takim i përbashkët me komisionin, po ashtu delegacioni do të ketë takime me përfaqësues të institucioneve më të larta.

Anëtarët e Komisionit u njoftuan se më 22 prill në orën 14,00, do të mbahet një takim me delegacionin nga Finlanda.

3.3. Sabri Hamiti lidhur me emërimin e ambasadorëve tha se Komisioni, sipas ligjit në fuqi ka për detyrë të bisedoj me kandidatët të cilët i propozon Ministria e Punëve të Jashtme. Pasi të vije propozimi i kandidatëve në Komisionin ne duhet të mbajmë seanca të mbyllura dëgjimore me kandidatët dhe në mënyrë konfidenciale të përcjellim rezultatet e dëgjimit.

Propozoi që si Komision kur të vije koha për dëgjimin e kandidatëve, të mblidhemi për të biseduar për metodën e punës dhe për përcaktimin e dy apo tre anëtarëve të Komisionit që të merren me zhvillimin e atyre bisedave.

Ramë Buja propozoi që në një mbledhje të Komisionit të diskutohet, për mënyrën e të vepruarit lidhur me këtë procedurë dhe të caktohen 2-3 deputetë për të zhvilluar bisedat.

Lutfi Haziri tha se kjo procedurë është konfidenciale dhe nuk lejohet prania e askujt. Mendon se Komisioni duhet të punoj në 2 nivele, niveli i parë duhet të vërtetohet se a i plotësojnë kushtet dhe në bazë së asaj se çfarë del, Komisioni ka të drejtë të bëjë edhe rangimin e emrave 1-2-3. Këta emra shkojnë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të vendit pritës për të dhënë mendim.

Sabri Hamiti në këtë procedurë ne duhet t'i përmbahemi nenit 6 dhe 7 të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Ardian Gjini pajtohet me mendimin e deputetit L. Haziri, lidhur me dërgimin e tre emrave nga MPJ tek vendet pritëse, për ta dhënë pëlqimin. Lidhur me punën konfidenciale tha se çka do të ndodh nëse një deputet e prish konfidencialitetin.

Ramadan Avdiu tha se emri i të deleguarit mbahet në konfidencë, edhe nëse nuk pranohet nga ai shtet emri i tij nuk do të publikohet, ndërsa sa u përket bisedave me kandidatët tha se duhet të jenë të njëtrajtshme për të gjithë.

Xhavit Haliti lidhur me formimin e grupeve të miqësisë tha se duhet diskutuar për nxjerrjen e rregullave për mënyrën e funksionimit të tyre. Shprehi pakënaqësi lidhur me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, për mënyrën e zgjedhjes së ambasadorëve sipas këtij ligji përmes konkursit, që nuk është praktikë në asnjë vend në botë. Sa i përket angazhimit të Komisionit për Punë të Jashtme në procedurën e përzgjedhjes së ambasadorëve, tha se është çështje krejtësisht formale dhe duhet punuar për amendamentimin të këtij ligji.

Ardian Gjini mendon se çështja e dëgjimit të kandidatëve pretendent për ambasadorë në mënyrë konfidenciale, nga ana e Komisionit nuk ka nevojë të bëhet fare. Përkrahë mendimin e deputetit Xh. Haliti, se puna e Komisionit nuk ka kurrfarë efekti dhe se duhet iniciuar procedurën për ndryshimin e ligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:
Njësia për Mbështetje të Komisionit